

STATISTIKAT E MBROJTJES SOCIALE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure (ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit	6
9.1 Shpeshhtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Manaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	10
19. Komente	11
Aneks	11

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Statistikave të Punësimit dhe Analizave Ndërsektoriale
1.3. Personi i kontaktit	Vera Breçani
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	vbrecani@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	26.01.2026
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	26.01.2026
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	26.01.2026
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Statistikat e Mbrojtjes Sociale përmbajnë të dhëna për treguesit kryesorë të Mbrojtjes Sociale në Shqipëri, të cilat përfshijnë ndërhyrjet që bëjnë organet shtetërore dhe private në lehtësimin e barrës financiare të familjeve dhe individëve në nevojë, të cilëve ju lind e drejta për këto përfitime. Kjo ndërhyrje mund të jetë në formën e pagesave në para kesh, në formën e rimbursimeve të shpenzimeve të bëra nga personat e mbrojtur ose në formën e mallrave dhe shërbimeve që u ofrohen drejtpërdrejt individëve që kanë të drejtë t'i përfitojnë ato. Treguesit statistikorë të Mbrojtjes Sociale përmbajnë informacion për numrin e personave përfitues të pagesës së papunësisë, për familjet dhe personat përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, personat përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar, përfituesit e pensioneve urbane dhe rurale në skemën e sigurimeve shoqërore etj. Informacioni mblidhet nga njësitë institucionale përgjegjëse sipas

	përcaktimeve ligjore, që rregullojnë ofrimin e përfitimeve sociale dhe financimin e tyre. Të dhënat janë siguruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni në fushën e mbrojtjes sociale siguron të dhëna për: • Të ardhurat dhe shpenzimet në fushën e mbrojtjes sociale; • Pensionet urbane dhe rurale; • Kontribuesit në sistemin e sigurimeve shoqërore; • Masën e pensionit sipas llojit; • Përfituesit e pensioneve të pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare; • Familjet përfituese në skemën e ndihmës ekonomike; • Kategoritë e personave në nevojë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike; • Fondin e ndihmës ekonomike; • Përfituesit e pagesës për aftësinë e kufizuar; • Përfituesit nga pagesa e papunësisë; • Masën e pagesës së papunësisë; • Kujdesi alternativ i fëmijëve.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Skemë e mbrojtjes sociale është një set i veçantë rregullash mbështetur nga një ose më shumë njësi institucionale që rregullojnë ofrimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale dhe financimin e tyre. Pensioni i pleqërisë është një pagesë periodike në të holla, që i paguhet personave të siguruar me qëllim mbajtjen e të ardhurave nga puna edhe pas daljes në pension. Pensioni familjar është një pagesë mujore në të holla të cilin kanë të drejtë ta marrin personat që janë në ngarkim të personit të siguruar që vdes, i cili përfitonte më përpara pension pleqërie ose pension invaliditeti. Pensioni i invaliditeti është një pagesë mujore në të holla të cilin kanë të drejtë ta marrin personat e siguruar që bëhen të paaftë: a) për çdo veprimtari ekonomike; b) kur ka gjymtime të forta dhe dëmtime fizike (duke përfshirë verbimin). Person me aftësi të kufizuar është individ, fëmijë ose i rritur, me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat në ndërveprim me barrierat të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë. Ndihma ekonomike është një pagesë periodike në para kesh që u jepet familjeve pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme dhe disa kategorive të personave në nevojë. Pagesa për aftësinë e kufizuar është një përfitim në para kesh dhe në natyrë që u jepet personave me aftësi të kufizuar të cilët plotësojnë kushtet për tu cilësuar të tillë, me qëllim lehtësimin e jetesës së tyre të përditshme. Pagesa e papunësisë është një përfitim në para kesh, që u jepet për një periudhë deri në 12 muaj personave të cilët dalin nga tregu i punës si të papunë dhe që kanë

	kontribuar në sigurimin e tyre shoqëror jo më pak se 12 muaj.
3.5. Njësia statistikore	Njësi statistikore janë: Skemat e mbrojtjes sociale; pensionistët, përfitues të pensioneve të pleqërisë, familjare dhe invaliditetit (urbane dhe rurale); familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike; personat në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike; personat që përfitojnë pagesë papunësie.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet popullsisë që përfiton: • Në skemën e sigurimeve shoqërore të pensioneve urbane dhe rurale, pensioneve të pleqërisë, pensioneve të invaliditetit, pensioneve familjare; • Në skemën e pagesës së papunësisë; • Në skemën e ndihmës ekonomike; • Në skemën për aftësinë e kufizuar; • Në qendrat e kujdesit social.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e statistikave të Mbrojtjes Sociale mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e statistikave të Mbrojtjes Sociale për skemën e pensioneve dhe të ndihmës ekonomike datojnë prej vitit 1998 dhe në vazhdim ndërsa të dhënat e statistikave të mbrojtjes sociale për skemën e papunësisë datojnë prej vitit 2000 e në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	• Numër mesatar vjetor i pensioneve urbane dhe rurale në skemën e sigurimeve shoqërore. • Numër mesatar katërmujor i familjeve dhe individëve në skemën e ndihmës ekonomike. • Numër mesatar tremujor i përfituesve të pagesës së papunësisë. • Fondi vjetor i ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes në ALL. • Pagesa e papunësisë në ALL. • Masa e pensionit mujor urban ose rural sipas llojit në ALL. • Shpenzimet dhe të ardhurat në skemat e mbrojtjes sociale, milion ALL.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periudha e references për statistikën e Mbrojtjes Sociale është vjetore. Ky raport i referohet të dhënave të vitit 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, statistikën e mbrojtjes sociale 2024 janë bazuar në:

	• Ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"; • Programi i Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Rregullorja (KE) Nr. 458/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 prill 2007, mbi sistemin evropian të statistikave të integruara të mbrojtjes sociale. • Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1322/2007, e datës 12 nëntor 2007, që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 458/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi sistemin evropian të statistikave të integruara të mbrojtjes sociale (ESSPROS), në lidhje me formatet e përshtatshme për transmetimin, rezultatet që duhet të transmetohen dhe kriteret për matjen e cilësisë për sistemin bazë të ESSPROS dhe modulën mbi përfituesit e pensione. • Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 263/2011, e datës 17 mars 2011, që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 458/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi sistemin evropian të statistikave të integruara të mbrojtjes sociale (ESSPROS), në lidhje me fillimin e mbledhjes së plotë të të dhënave për modulën e ESSPROS mbi përfitimet neto të mbrojtjes sociale. • Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 110/2011, e datës 8 shkurt 2011, që zbaton Rregulloren (KE) Nr. 458/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi sistemin evropian të statistikave të integruara të mbrojtjes sociale (ESSPROS), në lidhje me formatet e përshtatshme për transmetimin e të dhënave, rezultatet që duhet të transmetohen dhe kriteret për matjen e cilësisë për modulën e ESSPROS mbi përfitimet neto të mbrojtjes sociale. • Memorandume bashkëpunimi me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Shërbimin Social Shtetëror, Agjencinë Kombëtare për Punësim e Aftësim.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	INSTAT nuk transmeton tregues në Eurostat në lidhje me treguesit aktuale të të Mbrojtjes Sociale.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 124/2024, "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të

	tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Informacioni statistikor mbi të dhënat e Mbrojtjes Sociale publikohet në formë tabelare në Web-in e INSTAT në përputhje me kalendarin e aprovuar të publikimit çdo tremujor, katër mujor dhe publikim vjetor.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve mund të aksesohet online në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34, të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit të Statistikave të Mbrojtjes sociale janë si më poshtë: 1. Website 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Seksioni Kërkesa të dhënash, për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	

9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Të dhënat për Mbrojtjen Sociale janë publikuar me një frekuencë vjetore.
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Nuk aplikohet.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t'i gjejnë publikimet për mbrojtjen sociale në faqen e internetit të INSTAT të organizuara si më poshtë: Vjetore: • "Statistikat e Mbrojtjes Sociale"; • "Vjetari Statistikor Rajonal"; • "Burra dhe Gra në Shqipëri".
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhëna më të detajuara janë të publikuara në faqen web të INSTAT: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhëna mikro	Të dhënat e mbrojtjes sociale nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro. Të dhënat e agreguara janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Niveli më i detajuar i të dhënave të agreguara që merren është në nivel qarku.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kontakte në linku më poshtë: Kërkesë të dhënash .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative. Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikave të mbrojtjes sociale gjendet në faqen e INSTAT në seksionin lidhur me Metodologjinë mbi Statistikat e Mbrojtjes Sociale.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dokumenton gjithë procesin dhe procedurat e Statistikave të Mbrojtjes Sociale, për qëllimet e brendshme.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin "Për Statistikat Zyrtare, Nr. 17/2018," INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit,

	efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënave për Statistikat e Mbrojtjes Sociale është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e Statistikave të Mbrojtjes Sociale ndahen në të jashtëm dhe të brendshëm. Përdoruesit e jashtëm janë: • Institucionet e Administratës Publike; • Universitetet; • Bizneset; • Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; • Organizata kombëtare dhe ndërkombëtare jofitimprurëse; Përdoruesit e brendshëm janë drejtoritë prodhuese të INSTAT të cilat përdorin Statistikat e Mbrojtjes Sociale si input për punën e tyre.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vërtetimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Statistikave të Mbrojtjes Sociale është vlerësuar me 3.82 (76,4 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për statistikën e Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 gjykohej duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2022-2026). Shkalla e Plotshmërisë së Statistikave të Mbrojtjes Sociale për 2024 është 100%.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime

	dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.				
14. Afatet kohore dhe përpikmëria					
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Statistikave të Mbrojtjes Sociale vjetore janë publikuar në faqen e Web-it të INSTAT 391 ditë pas përfundimit të periudhës referuese, vitit.				
	Fusha statistikore	Periudha referuese	Data e publikimit	Afatet kohore	
	Mbrojtja Sociale	31.12.2024	26.01.2026	391 ditë	
	Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Mbrojtjes Sociale 2024 është 31 Dhjetor 2024.				
14.2. Përpikmëria	Fusha statistikore	Periudha referuese	Data e shpallur	Data e publikimit	Vonesa në kohë
	Mbrojtja Sociale	31.12.2024	24.11.2025	26.01.2026	63 ditë
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria					
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat e Mbrojtjes Sociale paraqiten në nivel vendi dhe sipas qarkut. Këto statistika janë të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave.				
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat e Mbrojtjes Sociale në lidhje me treguesit e pensioneve dhe ndihmës ekonomike sipas strukturës së familjes datojnë që nga viti 1998 referuar databazës statistikore, duke siguruar një krahasueshmëri të gjatë kohore prej 27 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=27).				
	Statistikat e Mbrojtjes Sociale në lidhje me treguesit e pagesës së papunësisë datojnë që nga viti 2000 referuar databazës statistikore, duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 25 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=25).				
	Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.				
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.				
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu vlerësimi i serive kohore dhe trendi i tyre.				

16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të mbrojtjes sociale pranë Sektorit të Statistikave të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është: 1 punonjës pranë zyrave qendrore të INSTAT.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e Revizionimit Statistikor; • Politika e Trajtimit të Gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Mbrojtjes Sociale do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Informacioni mbi Statistikat e Mbrojtjes Sociale grumbullohet nga burimet administrative. Ofruesit kryesorë të të dhënave të statistikave të mbrojtjes sociale janë përkatësisht: • Instituti i Sigurimeve Shoqërore; • Agjencia Kombetare për Punësim dhe Aftësim; • Shërbimi Social Shtetëror.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Mbledhja e të dhënave është e organizuar në periudha reference tremujore dhe vjetore. Të dhënat për ndihmën ekonomike, pagesën e aftësisë së kufizuar dhe pagesën e papunësisë mbledhen në bazë tremujore dhe vjetore, ndërsa të dhënat nga sigurimet shoqërore janë me bazë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Mbrojtjes Sociale, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Shërbimi kombëtar i Punësimit dhe Shërbimi Social Shtetëror janë burimi kryesor i grumbullimit të të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi. Pasi mbledhen të dhënat, i nënshtrohen kontrollit të cilësisë dhe analizave statistikore dhe në rast mungesash vijohet me komunikime (email, telefon) dhe kur është e nevojshme takime me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënat u janë bërë kontrole logjike dhe matematike. Këto kontrole kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e

	kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	